



Periodiku AMF

Mbi publikimin e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare për vitin 2009”

Pas raportimit në datë 13.04.2010 pranë Komisionit të Ekonomisë në Kuvendin e Shqipërisë, të Kryetares së AMF, Zj. Elisabeta Gjoni, “Mbi aktivitetin e institucionit për vitin 2009”, Kuvendi i Shqipërisë ka dërguar përmes një shkrese zyrtare nr. 1396, datë 21.05.2010, rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare për vitin 2009”.

Vijon në faqen 2

**Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura
Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-prill 2010**

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-prill 2010 arritën shifrën 2,732,311 mijë lekë, përkundëjt 2,658,243 mijë lekë të realizuara në janar-prill 2009 ose 2.79% më shumë.

Vijon në faqen 3

**Ngjarje dhe zhvillime të tjera
Zhvillohet aktiviteti dy ditor “Drejt një mbikëqyrje efektive me fokus rrezikun në sigurime dhe përshtatja e kuadrit ligjor”**

Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Bankën Botërore, zhvilloi në datat 24 - 25 maj 2010, në ambientet e hotel "Rogner Europapark", aktivitetin dy ditor “Drejt një mbikëqyrje efektive me fokus rrezikun në sigurime dhe përshtatja e kuadrit ligjor”.

Vijon në faqen 5

Zhvillohet konferenca mbi rregullimet globale financiare në periudhën e pas krizës

Shoqata e Ndërmjetësve të Letrave me Vlerë (ICSA), në kuadrin e mbledhjes së 23-të vjetore të Këshillit Ndërkombëtar të Shoqatave të Letrave me Vlerë, zhvilloi më datë 11 maj 2010, në Stamboll, Turqi, konferencën mbi rregullimet globale financiare në periudhën e pas krizës.

Vijon në faqen 6

Zhvillohet aktiviteti rajonal i mbikëqyrësve të sigurimeve në Evropën Qendrore, Lindore dhe Kaukaz mbi zbatimin teknikave dhe kërkesave të mbikëqyrjes me bazë risku

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) zhvilloi gjatë periudhës 18-21 maj 2010, Beograd, aktivitetin rajonal të mbikëqyrësve të sigurimeve në Evropën Qendrore, Lindore dhe Kaukaz mbi zbatimin e teknikave dhe kërkesave të mbikëqyrjes me bazë risku.

Vijon në faqen 7

Zhvillohet takimi mbi hetimin dhe gjykimin e tregtimit të brendshëm dhe rastet e manipulimit të tregut në rregulloren e letrave me vlerë

Gjatë periudhës 27-28 maj 2010, IOSCO, zhvilloi në Stamboll, Turqi, takimin mbi hetimin dhe gjykimin e tregtimit të brendshëm dhe rastet e manipulimit të tregut në rregulloren e letrave me vlerë.

Vijon në faqen 8

Zhvillohet kongresi mbi ligjin evropian për trafikun 2010

Akademia e Ligjit Evropian (ERA) zhvilloi gjatë periudhës 27-28 maj 2010, në Trier, Gjermani kongresin mbi ligjin Evropian për trafikun 2010.

Vijon në faqen 9

Zhvillohet konferenca mbi progresin në aspektin rregullator dhe mbikëqyrës ndaj tregut të sigurimeve

Organizata Ndërkombëtare e Tregjeve të Kapitalit (ICMA) zhvilloi gjatë periudhës 26-28 maj, në Bruksel, Belgjikë, konferencën mbi progresin në aspektin rregullator dhe mbikëqyrës ndaj tregut të sigurimeve.

Vijon në faqen 9

Edukimi i konsumatorit

Vijon nga numri i kaluar...

**Kriza financiare dhe sistemet e pensioneve të detyrueshme në vendet në zhvillim
(Material i marrë nga faqja zyrtare e Bankës Botërore, prill 2010)**

A preken edhe pensionet me përfitime të përcaktuara të skemës “PAYG”? Sistemet e pensioneve “PAYG” të lidhura me fitimet do të preken në mënyrë më pak dramatike dhe të menjëhershme, me zvogëlimin e të hyrave në sistem për shkak të rënies ekonomike dhe me rritjen e mundshme të kërkesave për pension.

Vijon në faqen 10

Në këtë numër:

Mbi publikimin e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare për vitin 2009”

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

5


Edukimi i konsumatorit

10

Mbi publikimin e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2009”

Pas raportimit në datë 13.04.2010 pranë Komisionit të Ekonomisë në Kuvendin e

Shqipërisë, të Kryetares së AMF, Zj. Elisabeta Gjoni, “Mbi aktivitetin e institucionit për vitin 2009”, Kuvendi i Shqipërisë ka dërguar përmes një shkrese zyrtare nr. 1396, datë 21.05.2010, rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2009”.





Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - prill 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-prill 2010 arritën shifrën 2,732,311 mijë lekë, përkundrajt 2,658,243 mijë lekë të realizuara në janar-prill 2009 ose 2.79% më shumë. Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 53.23% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 46.77% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme, primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 14.72% të sigurimeve të Jetës dhe 1.56% të sigurimeve të Jo-Jetës. 90.67% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 8.71% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës, ndërsa 0.62% e volumit të primeve të shkruara bruto u gjeneruan nga veprimtaria e risigurimit.


Gjatë periudhës janar-prill 2010 u nënshkruan rreth 189,557 kontrata sigurimi, ose rreth 17.81% më pak se në janar-prill të vitit 2009.



Volumi i primit të shkruar bruto, janar-prill (2009-2010)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2009	2010
Janar - Prill		
A) Sigurim i Jetës	207,490	238,025
B) Sigurim i Jo-Jetës	2,439,350	2,477,371
a) Sigurimi i Detyrueshëm	1,473,651	1,277,931
b) Sigurimi Vullnetar	965,699	1,199,440
c) Risigurimi	11,403	16,915
TOTAL	2,646,840	2,715,396

Volumi i primit të shkruar bruto, janar-prill 2010 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme

Gjatë periudhës janar-prill 2010, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 47.06% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për periudhën janar-prill 2010, arritën 940,993 mijë lekë, ose 2.50% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009.

Në janar-prill 2010, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 262,432 mijë lekë, ose rreth 41.19% më pak se në janar-prill 2009.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë periudhës janar-prill 2010 arritën në 74,506 mijë lekë, apo 19.56 % më shumë se në janar-prill 2009.


Sigurimet vullnetare

Në janar-prill 2010, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 1,454,380 mijë lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), ose 22.77% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe investimet në infrastrukturë. Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 1,216,354 mijë lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), vendin e parë e zunë sigurimet nga


zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 32.04% të pasuara nga, sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 27.45% dhe nga sigurimi kasko me 16.31%. Peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-prill 2010, arritën në 130,719 mijë lekë, 2.91% më pak se në janar-prill 2009. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 77.27% të të ardhurave të këtij grupi.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar-prill 2010 (Jo-Jeta)



Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar-prill 2010 (Jeta)



Primet në sigurimet e jetës në janar-prill 2010 arritën në rreth 238,025 mijë lekë, ose rreth 14.72% më shumë se në janar-prill 2009. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 31.07% të primeve.

Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 57.15% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-prill 2010 kapi vlerën 632,522 mijë lekë, ose 31.99% më shumë se në janar-prill 2009. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit të detyrueshëm me 546,250 mijë lekë, apo 86.38% të totalit.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet aktiviteti dy ditor “Drejt një mbikëqyrje efektive me fokus rrezikun në sigurime dhe përshtatja e kuadrit ligjor”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Bankën Botërore, zhvilloi në datat 24 - 25 maj 2010, në ambientet e hotel "Rogner Europapark", aktivitetin dy ditor “Drejt një mbikëqyrje efektive me fokus rrezikun në sigurime dhe përshtatja e kuadrit ligjor”.

Fjalën e hapjes e mbajti Kryetarja e AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, ku midis të tjerave prezantoi punën e bërë në bashkëpunim me First Initiative, mbi realizimin e Projektit “Për Mbikëqyrjen Efektive”.



Kryetarja e AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, gjatë zhvillimit të aktivitetit

Gjatë ditës së parë, drejtues dhe specialistë të AMF, u njohën me arritjet e projektit, punën e AMF dhe të ekspertëve të Bankës Botërore në drejtim të hartimit të manualit të integruar të mbikëqyrjes, i cili do të shërbejë si guidë në zbatimin e metodologjisë së re të mbikëqyrjes me bazë rrezikun. Zj. Serap Gonulal, eksperte financiare e Bankës Botërore, prezantoi etapat e punës me Projektin First, realizuar në bashkëpunim me BB. Më pas Zj. Anxhela Dervishi, Drejtore e Analizës e Raportimit pranë AMF prezantoi temën mbi kuadrin aktual ligjor dhe strukturën e mbikëqyrjes në fushën e sigurimeve në vend. Gjithashtu, në këtë panel, ekspertë të Bankës Botërore Z. Peter Van den Broeke dhe Z. Frank Machowiak, parashtruan drejtimet kryesore të përmirësimit të bazës ligjore dhe mbikëqyrjes të fushës së sigurimeve, me qëllim përshtatjen e saj, kësaj metodologjie të bazuar në rrezik. Në përfundim pati mjaft diskutime dhe shkëmbim eksperiencash ndërmjet Bankës Botërore dhe AMF.

Gjatë ditës së dytë, drejtues dhe specialistë të tregut të sigurimeve, u njohën me rezultatet e projektit “Për Mbikëqyrjen Efektive”, si draft-metodologjinë e re të mbikëqyrjes dhe përmirësimet e propozuara në kuadrin ligjor të fushës së sigurimeve.

Temat e trajtuara u ndoqën me mjaft interes e



Gjatë zhvillimit të aktivitetit "Drejt një mbikëqyrje efektive me fokus rrezikun në sigurime dhe përshtatja e kuadrit ligjor"

pati diskutime lidhur me eksperiencat përkatëse nga Drejtorët e Përgjithshëm të Shoqërive të Sigurimit.

Zhvillohet konferenca mbi rregullimet globale financiare në periudhën e pas krizës

Shoqata e Ndërmjetësve të Letrave me Vlerë (ICSA), në kuadrin e mbledhjes së 23-të vjetore të Këshillit Ndërkombëtar të Shoqatave të Letrave me Vlerë, zhvilloi më datë 11 maj 2010, në Stamboll, Turqi, konferencën mbi rregullimet globale financiare në periudhën e pas krizës.

Gjatë zhvillimit të konferencës u trajtuan temat: e ardhmja e rregullave të Tregut Global të Letrave me Vlerë; ristrukturimi i Tregjeve të Kapitaleve të Turqisë; Turqia si qendër financiare rajonale; e ardhmja e rregullave në Letrat me Vlerë në Evropë; e ardhmja e rregullave në Letrat me Vlerë në Azi; konvergjenca globale rregullatore dhe rregullimi i problemeve në nivel makro, si dhe e ardhmja e Tregjeve të Këmbimit.

Nga gjithë referimet dhe diskutimet u arrit në përfundimin se: situata pas krizës nuk është pesimiste; kriza që filloi si krizë kreditimi u shndërrua në krizë financiare dhe të tregjeve; risku është pjesë e tregut financiar; ai nuk mund të shmanget, por duhet të menaxhohet për të

minimizuar ndikimin negativ të tij në tregun financiar.

IOSCO, organizata që bashkon rregullatorët e tregjeve të kapitalit dhe promovon standarde të përbashkëta apo objektiva për rregullimin e tregjeve të kapitalit, ka një plan veprimi dhe masash që datojnë nga nëntori 2007 me krijimin e një Task Force, e cila iu adresua problemeve:

- transparenca e emetuesve dhe informimi i investitorëve;
- menaxhimi i riskut të firmave dhe mbikëqyrja e rreptë e tij, si dhe;
- vlerësimi i problemeve që dalin sidomos në kushtet e tregut jo likuid.

Kjo strukturë është fokusuar dhe do të vazhdojë të adresohet tek:

- standardet e raportimit financiar ndërkombëtar;
- krijimi i besimit të investitorëve nëpërmjet masave, si forcimi i zbatimit të bashkëpunimit cross-border;
- ndërtimi i një sistemi financiar të aftë për t'u rikuperuar nëpërmjet metodave rregullatore të reja për fondet në rast humbesh dhe marrëveshjeve më të forta për pastrimin dhe sistemimin e llogarive;
- transparenca e tregjeve dhe vendosja e standardeve në përputhje me produktet e strukturuar financiare.

Në konferencë u shpreh besimi, se kombinimi i iniciativave dhe punës së rregullatorëve të ndryshëm në aktivitetet e letrave me vlerë mund t'i sigurojë ata (rregullatorët) se zëri i tyre është dëgjuar në reformën e rregullimit global për t'ju përgjigjur krizës aktuale por edhe se ata mund të pajisen me mjetet e nevojshme dhe forcën për të identifikuar dhe minimizuar sa të jetë e mundur risqet që mund të lindin në të ardhmen.



Zhvillohet aktiviteti rajonal i mbikëqyrësve të sigurimeve në Evropën Qendrore, Lindore dhe Kaukaz mbi zbatimin e teknikave dhe kërkesave të mbikëqyrjes me bazë risku

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) zhvilloi gjatë periudhës 18-21 maj 2010, Beograd, aktivitetin rajonal të mbikëqyrësve të sigurimeve në Evropën Qendrore, Lindore dhe Kaukaz mbi zbatimin e teknikave dhe kërkesave të mbikëqyrjes me bazë risku.

Aktiviteti u fokusua në sqarimin e elementeve dhe teknikave të mbikëqyrjes me bazë risku, duke përdorur shembuj nga sisteme të ngjashme në zbatim në vende të ndryshme, si dhe vetë elementët e pritshëm të direktivës së Bashkimit Evropian “Solvency 2”.

Gjatë aktivitetit u trajtuan temat:

- **Standardet e IAIS-it.** Tema trajtoi qëllimin dhe metodën e hartimit të parimeve bazë të sigurimit të IAIS, si dhe revizionin dhe ristrukturimin aktual që këto parime po pësojnë në përgjigje të përvojës së industrisë së sigurimeve gjatë Krizës Botërore Financiare. Ndër shtesat dhe ndryshimet më të rëndësishme të pritshme do jetë trajtimi nga një ICP i veçantë i mbikëqyrjes makroekonomike dhe analizës së gjerë të tregut.
- **Kalibrimi i kapitalit dhe vlerësimit mbikëqyrës me nivelin e riskut.** Tema trajtoi në mënyrë të përgjithshme mbikëqyrjen me bazë risku dhe ndikimin e saj nga dhe në riskun e shoqërisë. U trajtuan gjithashtu: përkufizimi i riskut dhe llojet kryesore të riskut që has industria e sigurimeve, vështirësitë e hasura dhe metodat e pranuar për kuantifikimin e riskut, kultura e përgjithshme e menaxhimit të riskut në shoqëri dhe kalibrimi i kapitalit me riskun nga këndvështrimi mbikëqyrës (parimet e vlerësimit me bazë tregu të aktiveve dhe detyrimeve, vendosja e

disa niveleve të kapitalit të kërkuar, kërkesat për përputhjet e flukseve monetare të aktiveve e detyrimeve, etj.)

- **Zbatimi i standardeve të kapitalit në mbikëqyrjen e riskut.** Tema trajtoi përfaqshjen e Autoritetit Mbikëqyrës Financiar Zviceran (FINMA) në hartimin e kuadrit mbikëqyrës të bazuar mbi risk në këtë vend, përkundër qasjes së “Solvency 2”. Të dy sistemet mbështeten në analizën e gjithë zërave të bilancit, vlerësimin me bazë tregu të këtyre zërave dhe fokusimin në modelimin matematik të riskut të sigurimit, tregut (kryesisht atij financiar) dhe kreditit (ndërkohë që Solvency 2 shton edhe kërkesa në lidhje me modelimin e riskut operacional). U trajtuan problemet që lindin nga vlerësimi në bazë tregu të aktiveve e kryesisht të detyrimeve (teknika e portofolit replikues 'hedging' dhe kufijtë e zbatimit të saj), trajtimi i përgjithshëm i modeleve të riskut (ku vend të veçantë i lihet teknikës 'Value at Risk', e përdorur nga SST dhe Solvency 2), efekteve të diversifikimit, parimet e SST në lidhje me pranimin e modeleve të brendshme të firmave, si dhe të përvojës së shoqërive zvicerane të sigurimit gjatë Krizës Botërore Financiare.
- **Menaxhimi i riskut operacional.** Tema trajtoi metodat praktike dhe teorinë e sistemeve të menaxhimit të riskut operacional në shoqëri.
- **Modelet e brendshme të modelimit të riskut.** Tema trajtoi evolucionin e sistemeve të ndryshme të mbikëqyrjes, si dhe të modelimit të riskut, nga sistemet 'me faktorë', në sistemet aktuale të llogaritjes së aftësisë pagueuse. Vijoi trajtimi i llojeve të ndryshme të modeleve të brendshme të modelimit të riskut, si dhe të çështjeve të dala nga praktika e zbatimit të këtyre modeleve në shoqëri të ndryshme.
- **Stress testing dhe metoda e skenareve.** Tema trajtoi mangësitë e modeleve të kuantifikimit të riskut, të cilat mund të anashkalohej me përdorimin e stress testing dhe metodës së

skenareve, ndryshimet mes këtyre dy metodave, hapat bazë në ndërtimin e skenareve dhe llojet e tyre, hetimin e detajuar të marrëdhënieve të ndërvarësisë që ekzistojnë mes pasojave të ndryshme në një skenar realist, si dhe shembuj realë të skenarëve të ndryshme ekonomike (kriza ekonomike/buxhetore në Eurozonë) dhe jo-ekonomike (epidemi globale).

- **Qeverisja e korporatave.** Tema trajtoi qeverisjen e korporatës si një funksion bazë të menaxhimit të shoqërisë, duke diskutuar rolin e qeverisjes së korporatës gjatë krizës botërore financiare, të drejtat dhe përgjegjësitë e aksionarëve në shoqëri, modelet hierarkike të shoqërisë, parimet bazë të funksionimit të një këshilli mbikëqyrës efektiv, strukturimi i auditit të brendshëm, politikat e kompensimit në shoqëri dhe roli e fuqitë e mbikëqyrësit në kuadër të qeverisjes efektive të shoqërisë.
- **Mbikëqyrja e grupeve.** Tema trajtoi qëllimin e mbikëqyrjes së grupeve financiare, parregullsitë kryesore të vërejtura në marrëdhëniet brenda grupit, trajtimin e mbikëqyrjes së grupit në ICP-të aktuale dhe të ato të ristrukturuara, si dhe teknikat e ngritjes dhe funksionimit të kolegjeve mbikëqyrëse.
- **Sistemet e paralajmërimit në kohë dhe shkallët e ndërhyrjes mbikëqyrëse.** Tema trajtoi modelimin e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese, nivelit të kapitalit minimal, marrëdhëniet mes SCR dhe MCR, procesin e rishikimit të SCR dhe MCR, si dhe shembuj praktikë të metodave të llogaritjes dhe rishikim të SCR dhe MCR.

Aktiviteti përfshiu edhe diskutimin në grupe të Rasteve Studimore të marra nga praktika e mbikëqyrjes në Kanada dhe Zvicër në çështjet të mbikëqyrjes së grupeve dhe Mbikëqyrjes me Bazë Risku. Në përfundim të aktivitetit, u organizua një panel diskutimi ku u trajtua përvoja e Polonisë, si vendi

i rajonit që ka përparuar më shumë drejt mbikëqyrjes me bazë risku, pasuar nga ndarja e eksperiencës së gjithë vendeve pjesëmarrëse mbi programet e zbatimit të kuadrit rregullator me bazë risku.

Zhvillohet takimi mbi hetimin dhe gjykimin e tregtimit të brendshëm dhe rastet e manipulimit të tregut në rregulloren e letrave me vlerë

Gjatë periudhës 27-28 maj 2010, IOSCO, zhvilloi në Stamboll, Turqi, takimin mbi hetimin dhe gjykimin e tregtimit të brendshëm dhe rastet e manipulimit të tregut në rregulloren e letrave me vlerë.

Në këtë takim theksi u vu në zhvillimet e fundit të rregullatorit, sfidat, pozicionimi strategjik, planet e ardhshme të IOSCO-s, procesi i G20, drejtimi strategjik, etj.

Në ditën e parë të takimit u diskutuan temat: *përmbledhja e kursit dhe objektivat; IOSCO: Zhvillimet e fundit dhe sfidat e rregullatorit si dhe përdorimi i MMOU dhe teknikat investiguese; tregtia e brendshme, rregullat dhe rregullimet e manipulimit të tregut; përvojat dhe perspektivat e reja për mbikëqyrjen e tregut në Turqi; prezantimi i manipulimit të tregut; evidenca të tregtisë së brendshme; hetime dhe çështje gjyqësore për raste të tregtisë së brendshme; manipulimi i tregut, si dhe llojet e veçanta të manipulimit.*

Në fokus të ditës së dytë të takimit ishin studimet e rastit dhe ushtrime, si dhe u trajtuan temat: *seanca për manipulimin e tregut dhe studime rasti; tregtia e brendshme; studime rasti dhe ushtrime; mjetet juridike të klientëve, duke përfshirë zgjidhje alternative të konteksteve; si dhe mbrojtja e konsumatorit.*

Në përfundim të takimit u zhvilluan disa studime rasti për tregtinë e brendshme e pati mjaft diskutime lidhur me to.

Zhvillohet kongresi mbi ligjin evropian për trafikun 2010

Akademia e Ligjit Evropian (ERA) zhvilloi gjatë periudhës 27-28 maj 2010, në Trier, Gjermani kongresin mbi ligjin Evropian për trafikun 2010. Ky kongres u nda në dy pjesë dhe temat e trajtuara kishin të bënin me programin evropian 2010-2011 mbi sigurinë në rrugë, aksidentet rrugore ndër kufitare si një pikë bashkimi të ligjit kombëtar civil, penal, publik dhe atij të sigurimeve me atë të EU.

Një pikë e rëndësishme gjatë këtij kongresi ishte edhe propozimi i miratimit të një rregulloreje të re në lidhje me të drejtat e pasagjerëve në autobusë dhe trena. Projektregullorja do të përmbajë elementë të rinj në lidhje me ruajtjen e të drejtave të pasagjerëve dhe proceduara më të shpejta dhe të thjeshta në lidhje me të drejtën për dëm shpërblimit.

Në prezantimet e mbajtura ditën e parë u trajtuan temat lidhur me programin evropian 2010-2011 mbi sigurinë në rrugë, ku theksi u vu në konfliktin e ligjeve të vendeve të ndryshme në rastin e aksidenteve ndërkufitare, procedurat e përcaktimit të përgjegjësisë dhe pikat e bashkimi të ligjit kombëtar civil, penal, publik dhe atij të sigurimeve me atë të EU.

Me rëndësi ishte edhe diskutimi mbi përforcimin e detyrimeve që rrjedhin nga traktati i Lisbonës dhe zbatimi i vendimeve të vitit 2005 mbi sigurinë në rrugë në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian.

Gjatë ditës së dytë u diskutua mbi rëndësinë e miratimit të një rregulloreje të re në lidhje me të drejtat e pasagjerëve në autobusë dhe trena. Kjo rregullore do të krijojë një mundësi më tepër për mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve në transportin publik.

Kongresi krijoji mundësinë e mbajtjes së një forumi për diskutime mbi zhvillimet e fundit në

fushën e ligjit evropian mbi trafikun dhe praktikën e përditshme.

Zhvillohet konferenca mbi progresin në aspektin rregullator dhe mbikëqyrës ndaj tregut të sigurimeve

Organizata Ndërkombëtare e Tregjeve të Kapitalit (ICMA) zhvilloi gjatë periudhës 26-28 maj, në Bruksel, Belgjikë, konferencën mbi progresin në aspektin rregullator dhe mbikëqyrës ndaj tregut të sigurimeve. Gjatë punimeve të konferencës u diskutua mbi progresin dhe pasojat të pritshme, të cilat erdhën si rezultat i ndryshimeve të kryera në aspektin rregullator dhe mbikëqyrës ndaj tregut financiar.

Këto ndryshime ndodhën për shkak të kalimit të ndjeshëm nga një rregullim jo shumë i detajuar i dekadës së kaluar në një erë të re ku zbatimi i normave fokusohet në përcaktimin dhe reduktimin e riskut, me qëllim sigurimin e stabilitetit të sistemit financiar.

Synimi kryesor i konferencës ishte zbatimi i zhvillimeve të fundit, qoftë në një nivel të përgjithshëm, duke krijuar një kuadër ligjor tërësisht të ri në aspektin financiar dhe mbikëqyrës, si dhe një manual të vetëm Evropian rregullimesh ligjore në këtë fushë, në nivelin e iniciativave operationale të detajuara.

Ndër temat kryesore që u trajtuan përmendim:

- Menaxhimi i aseteve mbas krizës;
- Elasticiteti i infrastrukturës së tregut;
- E ardhmja e tregut të shitblerjeve;
- Çështjet me perspektivë mbas krizës, etj.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të shteteve të ndryshme synonte pikërisht krijimin e mundësive për përfshirje dhe kontribut më të madh të të gjithë vendeve në nivel ndërkombëtar.

Vijon nga numri i kaluar...

Edukimi i konsumatorit

Kriza financiare dhe sistemet e pensioneve të detyrueshme në vendet në zhvillim

(Material i marrë nga faqja zyrtare e Bankës Botërore, prill 2010)

A preken edhe pensionet me përfitime të përcaktuara të skemës “PAYG”?

Sistemet e pensioneve “PAYG” të lidhura me fitimet do të preken në mënyrë më pak dramatike dhe të menjëhershme, me zvogëlimin e të hyrave në sistem për shkak të rënies ekonomike dhe me rritjen e mundshme të kërkesave për pension. Në të vërtetë, rënia e re ekonomike globale do t'i zvogëlojë të ardhurat nga kontributet në shumicën e vendeve si pasojë e rënies së punësimit apo rënies së nivelit të fitimeve mbi të cilat vilen kontributet. Krahas kësaj, shpenzimet për pensionet nga këto skema ka të ngjarë të rriten me rritjen e numrit të punonjësve që dalin në pension për shkak të rënies ekonomike. Edhe pensionet e invaliditetit mund të rriten në përgjigje të rritjes së papunësisë.

Shkalla e efektit financiar varet ndjeshëm nga afati i maturimit të skemës. Vendet të cilat do të përballen me trysnitë më të mëdha fiskale janë ato ku flukset monetare nga kontributet dhe investimet janë më të vogla se shpenzimet afatshkurtra dhe ato ku rezervat likuide mund të përballen me trysnitë më të mëdha fiskale. Disa prej këtyre vendeve janë Azerbajxhani, Brazili, Egjipti, Maroku, Rusia, Serbia dhe Tunizia. Vendet që ndodhen në situatë financiare më pak të dobët do të duhet t'i zvogëlojnë përkohësisht tepricat monetare dhe/ose të tërheqin nga rezervat. Por, ekziston mundësia e riparimit të pasojave me të kaluar kriza.

Pasojat për anëtarët do të varen nga mënyra me të cilën do t'i trajtojnë qeveritë mungesat në të ardhurat e skemave. Ato mund t'i financojnë

plotësisht deficitet e skemave të pensioneve. Një alternativë tjetër do të ishte mospërbushja e pjesshme e premtimeve për pensione, përmes vonimit të pensioneve ose përmes mosindeksimit të pagesave, për shembull. Drejtpeshimi midis dy alternativave do të vendoset politikisht, duke qenë se pensionet janë vetëm njëra prej kërkesave që konkurrojnë për burimet e kufizuara publike. Vështirësia kryesore do të shihet në vendet që kanë deficite të përgjithshme fiskale dhe që mbështeten në financimin me borxh të jashtëm, i cili është bërë më i vështirë për t'u rifinancuar pas krizës globale financiare.

Në disa raste (siç ka ndodhur kohët e fundit në Argjentinë) vendet që kanë futur shtylla të dyta me fonde mund të ndodhen përpara ngasjes për ta rikalar pjesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore që më parë shkante për skemat “PAYG”, në skemat publike. Megjithëse kjo mund t'u japë zgjidhje problemeve të flukseve monetare afatshkurtra, ajo nuk e përmirëson pozicionin e përgjithshëm të pasiveve publike neto dhe ekziston rreziku që ajo të ketë pasoja negative afatgjata për pozicionin e pensioneve individuale. Krahas zvogëlimit të diversifikimit të sistemit të pensioneve të pleqërisë, në përgjithësi, dhe vendosjes së punonjësve në rrezik për shkak të zvogëlimit të përfitimeve të ardhshme nëse sistemi nuk vazhdon të jetë i vetëqendrueshëm në periudhën afatgjatë, kur do të ketë edhe rritje të detyrimeve, kjo do të mbyllë edhe llogaritë e mbuluara me fonde kur vlerat e aseteve do të jenë të ulëta, duke sjellë humbje dhe duke mos i lejuar anëtarët të përfitojnë nga rikuperimi i mundshëm i çmimeve.

Përgjigjet afatshkurtra

Në periudhën afatshkurtrë, qeveritë këshillohen të mos reagojnë në mënyrë të tepruar ndaj kushteve të tanishme ekonomike dhe t'i analizojnë me kujdes pasojat e plota të përgjigjeve përmes politikave në kuadër të horizontit planifikues afatgjatë që lidhet me pensionet. Bëhen tri rekomandime:

Së pari, qeveritë duhet ta evitojnë kthimin mbrapa të reformave që nuk janë vlerësuar si duhet dhe që mund të shkaktojnë një çmim të lartë për pensionistët e ardhshëm.

Kalimi i punonjësve me më shumë se pesë vjet larg daljes në pension në një sistem “PAYG” mund të jetë atraktiv politikisht. Mirëpo, kjo kërkon që qeveritë të mbartin një detyrim të nënkuptuar me sistemin “PAYG” (në këmbim të aseteve që marrin tani hua) dhe kjo do të duhet të financohet në të ardhmen. Kufizimi i kontributeve në sistemet me fonde në periudhën e tanishme do t'ua hiqte anëtarëve mundësinë për të marrë pensione më të larta në ardhmen. Kjo është sidomos e vërtetë tani që anëtarëve e skemave mund të blejnë asete me çmime relativisht të ulta dhe, kështu, të nxjerrin fitime të mundshme të mëdha.

Po kështu, kalimi i aseteve në instrumente të cilat perceptohen si më të sigurt, siç është borxhi afatshkurtër shtetëror, mund t'i kënaqë anëtarët me llogari në rënie, por do t'i kufizojë shumë mundësitë për pensione më të larta. Analiza e modeleve historike në tregjet e aseteve të vendeve të zhvilluara tregon se, përkundër luhatjes së ndjeshme të normave të kthimit për shkak të luhatjeve të tregut, një portofol i diversifikuar asetesh do të sillte një nivel më të lartë kursimesh për pensionin e pleqërisë thujse gjatë të gjitha periudhave kohore (shih Munnell, Webb, dhe Golub-Sass, 2008).

Së dyti, qeveritë duhet ta pranojnë se kriza e tanishme financiare është një ngjarje “e skajshme” e rrallë. Si e tillë, ajo kërkon masa të përkohshme për të trajtuar pasojat e krizës, dhe jo ndryshime strukturore në politikë. Për më tepër, çdo masë kompensuese që mund të shqyrtohet, duhet të strukturohet me kujdes. Pas vendosjes së këtyre masave, do të jetë shumë e vështirë të eliminohen kur kushtet të mos i kërkojnë më.

Së treti, është mirë që qeveritë të mos i nënvlerësojnë pasojat e mundshme pozitive që mund të kenë

investuesit institucionalë afatgjatë (siç janë fondet e pensioneve) për financimin e ndërmarrjeve të sistemit financiar dhe, në fund, për punësimin dhe rritjen ekonomike. Vendet me fonde pensionesh të zhvilluara mirë, të rregulluara dhe të mbikëqyrura (siç është Kili) kanë mundur të kalojnë tronditjet ekonomike në të shkuarën edhe më mirë, si blerja e obligacioneve tregtare pjesërisht të kompensuara për uljen e mundësisë për të marrë kredi bankare. Është parë se fondet e pensioneve po hyjnë në tregjet e kredive, të cilat më parë janë mbizotëruar nga bankat e nivelit të dytë dhe bankat e investimeve (si, për shembull, në Vendet e Ulta).

Duhen marrë në shqyrtim masat e mëposhtme afatshkurtra:

- *Realizimi i një fushate për informimin e publikut, për t'ua shpjeguar situatën anëtarëve të skemave të pensioneve me fonde dhe me përfitime të përcaktuara, duke dhënë informacion të hollësishëm për pasojat faktike dhe ato të pritura për përfitimet e punonjësve të grup-moshave të ndryshme dhe duke përshkruar masat e ndryshme, si pensionet minimale dhe/ose pensionet jo të mbështetura në kontribute që jepen për të mbrojtur shtresat më të varfra dhe më të prekshme të popullsisë. Idealja do të ishte që një punë e tillë të bëhej në çdo rast, për të përmirësuar njohuritë dhe aftësinë financiare të punonjësve, e cila do të ketë pasoja afatgjata pozitive edhe jashtë sistemit të pensioneve. Kriza e tanishme mund të japë shtysën për një punë të tillë dhe të krijojë mundësinë ideale që kjo të jetë më e efektshme duke qenë se punonjësit janë më të ndjeshëm ndaj çështjeve financiare.*
- *Krijimi i një kuadri për krijimin e shumave vjetore me faza apo të shtyra në kohë apo për alternativën e marrjes së përfitimeve përmes tërheqjes me faza me të arritur moshën e daljes në pension. Kjo është e rëndësishme për të gjitha ato skema me fonde për të cilat krijimi i*

shumave vjetore është i detyrueshëm. Sikurse diskutohet më lart, individët që ndodhen më shumë në rrezik nga rënia e shpejtë e vlerave të aseteve janë ata të cilët ndodhen shumë pranë daljes në pension të cilët ka shumë të ngjarë të pësojnë rënie të mëdha të vlerës kur t'i konvertojnë kursimet e tyre në një shumë vjetore. Lejimi i tërheqjes me faza dhe i blerjes graduale të shumave vjetore mund t'u japë mundësi individëve të realizojnë efektet e një rikuperimi të mundshëm duke mos kërkuar likuidimin e aseteve të investuara gjersa t'i jepet njëfarë kohe vlerës së tyre për t'u rikuperuar.

- *Marrja në konsideratë e një programi të kufizuar në fushëveprim dhe në kohë për atë grup të vogël që del në pension në mes të krizës dhe që do të preket më shumë.* Në të vërtetë, ka disa punonjës, kryesisht me të ardhura të ulta, me nivele të ulta kursimesh të cilët, edhe me blerjen e një shume vjetore me faza apo me një program të tërheqjes, të duhet t'i likuidojnë në periudhën afatshkurtër llogaritë e tyre në rënie. Ky grup mund të ndihmohej përmes programeve që ofrojnë një kthim minimal të garantuar, të ngjashëm me atë që është ofruar në sistemin bankar në përgjigje të krizës. Kjo ndihmë duhet të jetë e arritshme vetëm për ata persona që janë afër daljes në pension dhe të jepet në bazë të nivelit të të ardhurave. Parimi do të ishte kompensimi i individëve të cilët përballen me një rënie të madhe të normave neto të zëvendësimit. Më pas, një punë e tillë do të shkonte me faza drejt eliminimit me arritjen e një pike të caktuar të rimëkëmbjes. Por, në çdo rast, është mirë të analizohen me kujdes kostot oportune dhe pasojat shpërndarëse të burimeve publike.
- *Dhënia e ndihmës sistemeve “pay-as-you-go” për të pasur vetëqëndrueshmëri financiare dhe mbrojtja e përfitimeve të punonjësve me të ardhura të ulta.* Sikurse propozohet më lart, në shumë raste mund të jetë nevoja që qeveria të japë financim shtesë për skemat publike të

pensioneve për të kompensuar rënien e prurjes së kontributeve të punonjësve. Qeveria mund të shikojë edhe mundësitë për të maksimizuar mbrojtjen e punonjësve me të ardhura të ulta të cilët përballen me rënie të pagave, duke ofruar pensione minimale afrofe dhe një indeksim të plotë të përfitimeve. Por, një përpjekje e tillë duhet të mbajë parasysh se shumë sisteme pensionesh të llojit “PAYG” mbulojnë vetëm pakicën më të pasur të krahut të punës dhe se një mbështetje e tillë mund të jetë në kurriz të grupeve të tjera në pozita më të cenueshme të cilët nuk i mbulon sistemi formal i pensioneve.

- *Rishqyrtimi i rregullave të vlerësimit të zbatueshme për asetet e fondeve të pensioneve, në kuadër të luhatjes së skajshme të tanishme në tregjet financiare.* Ka pasur një prirje të tanishme, përgjithësisht pozitive, drejt kërkesave për të bërë një vlerësim sipas tregut të aseteve të të gjitha llojeve të institucioneve financiare, përfshirë edhe fondet e pensioneve. Edhe pse, në përgjithësi, kjo e rrit transparencën dhe vlerën e dhënies së informacioneve, mund të ketë raste, siç është kriza e tanishme, në të cilat kjo është kundërproduktive. Entet rregullatore dhe mbikëqyrëse (siç kanë vepruar tashmë disa) mund të shqyrtojnë idenë e lirit të këtyre rregullave për vlerësimet kur ndodhin lëvizje të skajshme afatshkurtra të çmimeve. Njëfarë rrumbullakosjeje në periudha të luhatjeve ekstreme i pasqyron më me saktësi vlerat e vërteta bazë dhe e shmangin mundësinë e reagimeve me efekt të padëshirueshëm ndaj ndryshimeve të mëdha të cilat dalin se janë shumë afatshkurtra.

Përgjigjet afatmesme

Kriza financiare u jep një shtysë të fuqishme të gjitha vendeve ta rishikojnë strukturën dhe vënieën në zbatim të politikave, për t'i arritur më mirë objektivat qendrorë të sistemeve të pensioneve të pleqërisë. Kjo krizë nënvizon, në

veçanti, vlerën e diversifikimit në skemën e përgjithshme të sistemit dhe nevojën për t'i administruar në mënyrë të efektshme rreziqet që shoqërojnë skemat e mbuluara me fonde. Në periudhën afatshkurtër, është mirë t'u kushtohet vëmendje çështjeve të mëposhtme:

- *Diversifikimi më i mirë i administrimit të risqeve financiare dhe risqeve të tjera makroekonomike.* Kriza financiare e mbështet edhe më shumë argumentin për një sistem pensionesh me disa shtylla, i cili mund të ketë qëndrueshmëri të lartë në rast të trazirave të rënda financiare dhe ekonomike. Sistemi me disa shtylla do të përfshinte elemente të një pensioni social të synuar mirë apo të një pensioni minimal të garantuar (shtylla zero) për të siguruar mbrojtjen e gjerë nga varfëria, një shtyllë të parë të bazuar në fitime të qëndrueshme dhe një shtyllë të dytë me fonde. Të tri këto shtylla, duke punuar së bashku, do të jepnin përfitime për popullsinë e gjerë edhe gjatë niveleve të ulëta të ciklit ekonomik. Pyetjet kyçe për qeveritë do të jenë: (i) si të vendoset niveli i pensionit bazë dhe kushtet për ta përfituar atë; dhe (ii) si të caktohet norma e kontributit midis shtyllës së parë (e cila është më e zbuluar ndaj risqeve të tregut) dhe shtyllave të dyta (të cilat janë më të zbuluara ndaj risqeve financiare).
- *Përmirësimi i administrimit të risqeve financiare.* Për shtyllat me fonde (të dyta dhe të treta), kriza duhet ta nxisë rilindjen e vëmendjes ndaj rëndësisë së administrimit të zhvilluar mirë të rreziqeve dhe ndaj standardeve të drejtimit të brendshëm të shoqërive, duke i integruar këto në rregullimin dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve. Krahas kësaj, është mirë të shikohet mundësia e mekanizmave për t'i mbrojtur më mirë pensionistët nga efekti i luhatjeve të llogarive menjëherë përpara daljes në pension. Këtu mund të përfshihet futja e portofoleve të bazuar në moshë/cikël jete të cilët u kërkojnë punonjësve me të ardhura të ulta dhe të mesme të kalojnë një

pjesë të tepricave të tyre në investime me më pak rrezik, me afrimin e moshës së pensionit. Edhe shpërndarja automatike e aseteve të lidhura me moshën dhe fitime është e rëndësishme, në dritën e lëvizjes së vërejtur të kontribuesve.

- *Bërja e sistemeve "PAYG" më të qëndrueshme, më të forta dhe më të sigurta.* Për shtyllën e parë, është mirë që vendet të shikojnë mundësinë e miratimit të skemave me kontribute nacionale të përcaktuara ku përfitimet lidhen me kontributet dhe me jetëgjatësinë e pritur në kohën e daljes në pension. Idealja do të ishte që këto sisteme të përfshinin një fond rezervë dhe një mekanizëm drejtpeshues të përshtatshëm për rregullimin e zhvillimeve demografike dhe ekonomike. Si minimum, është mirë që vendet me sisteme tradicionale me përfitime të përcaktuara të fusin ndryshime në formulat e përfitimeve dhe kushtet për përfitimin e tyre: (i) për të përfshirë gradualisht pagat në llogaritjen e pensionit, ku pagat e shkuara të indeksohen me normën e rritjes së pagës mesatare të mbuluar; dhe (ii) për ta lidhur llogaritjen e normës së lindjes së përfitimit me moshën e daljes në pension dhe normën e kontributit. Nëse miratohen këto dy masa, vendet mund të shikojnë edhe mundësinë e indeksimit automatik të pensioneve.
- *Pasja e një shtylle zero të strukturuar mirë aty ku është e përballueshme dhe e justifikueshme financiarisht.* Një shtyllë zero e projektuar mirë apo futja e një pensioni minimal të garantuar në një rën prej shtyllave mund t'i zbusë pasojat e luhatjeve ekonomike të ardhshme mbi individët e moshuar në pozita të cenueshme. Këto sisteme lipset të strukturoren me kujdes për të siguruar përballueshmërinë financiare të tyre dhe që ato të mos kenë pasoja negative.
- *Integrimi i kursimeve të papunësisë dhe i mundësisë së sigurimit në sistemin e përgjithshëm të sigurimeve shoqërore.* Sistemet e

pensioneve mund të kthehen në sisteme de facto papunësie në periudhat me probleme ekonomike duke qenë se punonjësit që i humbasin vendet e punës kërkojnë të marrin përfitime pensioni apo invaliditeti kur nuk kanë alternativa të tjera në dispozicion. Disa vende duhet të shikojnë mundësinë e kufizimeve më të rrepta mbi pagesat e invaliditetit dhe daljen në pension para kohe, duke fuqizuar në të njëjtën kohë sistemet e mbrojtjes së të ardhurave për punonjësit që humbasin vendin e punës. Mundësitë e politikave përfshijnë ndërthurjen e sigurimit ndaj papunësisë dhe llogaritë individuale të kursimit për papunësinë të cilat mund të përdoren gjatë periudhave të papunësisë.

ndaj atyre tronditjeve ekonomike si ajo që po ndjehet tani.

- Duhet treguar vëmendje gjithnjë e më e madhe për administrimin e zbulimit të individëve ndaj rreziqeve financiare afatshkurtra përmes portofoleve të strukturuar, për punonjës të cilët janë duke iu afruar moshës së daljes në pension, si edhe përmes zhvillimit të kalimit me faza drejt ofrimit të pagesave të cilat e kufizojnë efektin e luhatjeve financiare afatshkurtra.

Konkluzione dhe rekomandime:

- Efekti i krizës financiare shkon përtej humbjeve të menjëhershme të aseteve të fondeve të pensioneve.
- Është mirë të evitohen ndryshimet e papritura të politikave në përgjigje të rrethanave të menjëhershme. Sistemet e pensioneve janë strukturuar të funksionojnë në periudha shumë të gjata kohore. Përgjigjet afatshkurtra ndaj rrethanave relativisht të rralla mund të kenë pasojë afatgjata negative për kapacitetin e sistemeve të pensioneve për të siguruar nivele adekuate të ardhurash për pensionistët.
- Mund të shikohet ideja e marrjes së masave për t'i zbutur pasojat për numrin relativisht të vogël të individëve që dalin në pension, pa e ndryshuar në themel skemën e sistemit.
- Kriza e tanishme e përforcon nevojën për sisteme pensionesh të diversifikuara me disa shtylla të cilat të jenë në gjendje t'i administrojnë risqet dhe t'i mbrojnë individët që mund të ndodhen në pozita të cenueshme

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, M. Marku, J. Kurti,
P. Berberi, Etjon Basha, L. Lloji, K. Myftari,
R. Eltari, E. Kokona

